



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:020643  
Datë: 31.01.2025  
Numri i dokumentit: 06789142

Pml.nr.21/2025

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Agim Maliqi dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit J. Sh., për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë P.nr.239/2022 të datës 21.07.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.776/2024 të datës 30.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 30 janar 2025, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

*Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit J. Sh. e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë P.nr.239/2022 të datës 21.07.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.776/2024 të datës 30.05.2024.*

*A r s y e t i m*

**Vendimi i Gjykatës Themelore**

*Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, me aktgjykimin P.nr.239/2022 të datës 21.07.2023, të dënuarin J. Sh. e ka shpallur fajtor për veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) € dhe dënim burgimi në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve i cili dënim është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 800 (tetëqind) €. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor, dhe shumën prej 20 €, në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, kurse e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.*

### **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

*Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.776/2024 të datës 30.05.2024, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe mbrojtësit të të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.*

### **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

*Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Refik Basha nga K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimet e kundërshtuara t'i anulon dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.*

### **Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit**

*Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.09/2025 e datës 23.01.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.*

### **Pretendimet e paraqitura në kërkesë**

*Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe të cilat shkelje nuk janë elaboruar, meqë pretendohet se duhet të shqyrtohen sipas detyrës zyrtare.*

*Tutje pretendohet për shkeljen e ligjit penal në dëm të të dënuarit, meqë në rastin konkret theksohet fakti se gjykata e dy instancave gjyqësore, përkatësisht gjykata e shkallës së parë, por edhe e shkallës së dytë nuk kanë vlerësuar shkallën e përgjegjësisë së të dënuarit, meqë ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale pasi që mungon lidhja kauzale mes veprimit dhe pasojës e përcaktuar me dispozitën e nenit 20 të KPRK-së.*

### **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

*Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:*

*- kërkesa nuk është e bazuar.*

*Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të pabazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.*

*Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale pati parasysh dispozitën e nenit 436 par.1 të KPP-së e cila ka përcaktuar se: “Me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon”, andaj bazuar në këtë ndalesë nuk shqyrton pretendimet sipas detyrës zyrtare, siç theksohet në kërkesën e parashtruar nga ana e mbrojtësit të të dënuarit.*

*Duke vlerësuar pretendimet përkitazi me shkeljen e ligjit penal, Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se në këtë çështje penale nuk gjeti shkelje të pretenduara, meqë pajtohet në tërësi me konkludimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore se në veprimet e të dënuarit janë formësuar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën i dënuari është gjykuar. Për më tepër, duke vlerësuar pretendimin për përjashtimin e përgjegjësisë penale, përveç faktit që nuk është potencuar ndonjë pretendim konkret, megjithatë duke u bazuar në shkresat e lëndës del se i dënuari është penalisht përgjegjës pasi që nuk është kontestuar aftësia e tij në aspektin mendor. Gjithashtu dy gjykatat e instancave më të ulëta gjyqësore kanë dhënë*

*konkludime të qarta dhe të plota përkitazi me lidhjen kauzale mes veprimit dhe pasojës gjegjësisht si rezultat i veprimit të të dënuarit duke i premtuar të dëmtuarës përfitimin e grantit në shumë prej 30.000 € e duke marrë shumë prej 3000 €, me ç'rast del se janë realizuar në tërësi elementet e veprës penale në fjalë.*

*Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**

*Pml.nr.21/2024, më 30 janar 2025*

*B.profesionale,  
Qefsere Berisha*

*Kryetarja e kolegjit,  
Valdete Daka*